

Drita Xhemaili, MA¹

UDC:
37.018.556(430:=18)

**DYGJUHËSIA TE FËMIJET E PUNËTORËVE SHQIPTARË
(GASTARBEITER) TË GJENERATËS SË DYTË DHE TRETË NË
GJERMANI - FORMAT DHE PASOJAT**

**ДВОЈАЗИЧНОСТА КАЈ ДЕЦАТА ОД АЛБАНСКИ
РАБОТНИЦИ (GASTARBEITER), ОД ВТОРА И ТРЕТА
ГЕНЕРАЦИЈА ВО ГЕРМАНИЈА - ФОРМИ И ПОСЛЕДИЦИ**

**BILINGUALISM IN CHILDREN OF ALBANIAN WORKERS
(GASTARBEITER) OF THE SECOND AND THIRD
GENERATION IN GERMANY, ITS FORMS AND
CONSEQUENCES**

Abstract

The purpose of this study is to provide a theoretical and empirical review of bilingualism in children of the second and third generation of Albanian foreign workers (Gastarbeiter) in Germany, its forms and consequences. The object of this study is also the clarification of the definition of bilingualism on which scientists of different fields such as: linguistics, sociolinguistics, psycholinguistics and language studies have laid out their theories on this matter. We will also go into the question of when can we call a person bilingual, the level of knowledge of the second language, as well as how competent they are in using the second language. This study provides a reflection of the difficulties that

¹ Universiteti "Shen Kirili dhe Metodi" Shkup, Fakulteti i Filologjisë,
drita_xhemajli@hotmail.com

children of the second and third generation of foreign workers (Gastarbeiter) face in Germany which according to PISA, the second generation has certain problems in future education while the third generation does not because they are already integrated into the language and the culture of the country of residence, however they do face language and cultural identity problems.

Key words: bilingualism, children of second and third generation, foreign workers, Germany.

Hyrje

Në botën e globalizuar ku dygjuhësia duket se nuk është më një fenomen, prapëseprapë ende s'ka një pajtueshmëri në mes shkencëtarëve të fushave të ndryshme mbi përkufizimin e dygjuhësisë. Një gjuhësia në shekullin e XXI në popullsinë e botës është më tepër një përjashtim sesa dygjuhësia, për vetë faktin se në mbarë botën shumë njerëz vijnë dhe mbliidhen së bashku në vende të ndryshme të botës nga arsye të ndryshme, si p.sh gjendja sociale, politike, kulturore etj.

Veçanërisht në Gjermani, ka një numër të madh të njerëzve që flasin edhe një gjuhë tjetër përveç asaj gjermane. Qëllimi i këtij punimi është të parashtrij pyetjen se: çfarë roli luan dygjuhësia te fëmijët e punëtoreve të gjeneratës së dytë dhe të tretë në Gjermani dhe sa këta fëmijë e zotërojnë gjuhën amtare si dhe ku qëndron lidhshmëria e tyre?

Përgjigjen e kësaj pyetje në literaturën profesionale dhe në shkencë në përgjithësi e gjejmë në lidhshmëri me kulturën dhe gjuhën që e flasin, duke pasur parasysh se secili popull ka mënyrën e vetë të të menduarit, normat dhe vlerat. Pikërisht nga aspekti gjuhësor në këtë punim do të japë një pasqyrë lidhur me përcaktimin e definicionit të "*dygjuhësisë*" duke u mbështetur në hulumtimet teorike dhe empirike që janë bërë deri tani. Duke u thelluar në sqarimin e termit "*dygjuhësi*" se çka nënkuptojmë me këtë term në shkencë si dhe kur mund ta quajmë një njëri dygjuhësor? Po ashtu do të jepem sqarime rreth përdorimit të dygjuhësisë dhe ndarjes së saj.

Në bazë të hulumtimeve në fushën e linguistikës, psikologjisë dhe sociologjisë do të japim një pasqyrë të shkurtër se çka mendojnë disiplinat e ndryshme rreth çështjes së dygjuhësisë dhe çfarë arritje dhe njohuri kemi në këtë drejtim.

Bilingualizmi si term i përgjithshëm i dygjuhësisë

Nën përkufizimin e dygjuhësisë janë bërë hulumtime të panumërta nga linguist të njohur botëror, psiko-linguist, socio-linguist dhe ende nuk është arritur asnjë pajtueshmëri për një përkufizim konkret të këtij termi. Pajtueshmëri në mes të disiplinave të sapopërmendur është arritur në atë se aty përfshihet përvetësimi i dy gjuhëve nga një individ apo person. Kjo ngre edhe një herë çështjen e asaj se, çka është dygjuhësia dhe kur mund të quhet një individ si dygjuhësh?

Hulumtimet e deritanishme empirike dhe teorike janë përqendruar në çështjen e përkufizimit dhe klasifikimit të dygjuhësisë (sh. Lambeck, 1984) dhe në cilën shkallë zotërohen të dy gjuhët dhe në çfarë marrëdhënie apo raporti qëndrojnë gjuhët me njëra-tjetrën dhe sa lloje të dygjuhësisë kemi?

Në lidhje me këtë problematik në linguistik ka shpjegime të shumta, por ato janë karakterizuar ose të pasakta ose kontradiktore në mes vete. Lambeck (1984) përfaqëson mendimin, se dygjuhësia vjen në shprehje atëherë kur një person zotëron më shumë se një gjuhë “*der dadurch gekennzeichnet ist, dass mehr als eine Sprache in Erscheinung tritt*”². Pikëpamje të ngjashme ka edhe George Saunders (1988), i cili thote: “*Bilingualism, therefore, simply means having two languages (and bilingualism is often used in the literature to mean the seam as multilingualism, that is, having more than two languages)*”. Dygjuhësia, pra, thjesht do të thotë të zotërosh dy gjuhë (dygjuhësia shpesh përdoret në literaturë për të nënkuptuar të njëjtën gjë si shumëgjuhësia, domethënë të ketë më shumë se dy gjuhë)”.

Se përse është kaq e vështirë të hulumtohet dhe të përkufizohet termi i bilingualizmit, qëndron në faktin se ekzistojnë shumë përkufizime apo pikëpamje të cilat janë të pranishme dhe në këtë mënyrë mbizotërojnë mosmarrëveshje të përgjithshme mbi këtë temë.

Këto pikëpamje të ndryshme mbi dygjuhësinë lindin nga fakti se shumë disiplina të tilla si linguistika, sociologjia, psikologjia dhe pedagogjia hulumtimet e tyre i zhvillojnë nga aspekti dhe këndvështrimi i tyre, si për shembull, psikologjia merret me proceset mendore, sociologjia sjell dygjuhësinë në lidhje me kulturën dhe shoqërinë si dhe pedagogjia ka të bëjë me paraqitjen e dygjuhësisë në shkollë dhe arsim në përgjithësi. Në thelb dygjuhësia ose shumëgjuhësia është shqyrtuar

² Lambeck 1984, f. 12.

në të gjitha disiplinat në dy nivele në të njëjtën kohë dhe bëhet dallimi midis dy pikëpamjeve të kundërta, asaj maksimaliste dhe asaj minimalist.

Kompetenca gjuhësore dhe përdorimi i gjuhës

Tashmë siç edhe është përmendur në pjesën e parë, se ka pikëpamje të ndryshme në përkufizimin e dygjuhësisë dhe kur mund ta quajmë apo të konsiderohet një individ si dygjuhësh, për më tepër, do të përpiqemi të shpjegojmë pozicionet e kundërta maksimaliste dhe minimalist. Përkufizimet maksimaliste ideale vijnë në shprehje kryesisht nga Bloomfield (1933) dhe Brown (1937). Bloomfield beson se një folës dygjuhësh mund të quhet bilingual nëse ka aftësi ta zotërojë edhe gjuhën e huaj sikur se e zotëron gjuhën e nënës në përputhje me rrethanat dhe e përcakton si *“the native-like control of two languages”*³. Siç mund të shihet në bazë të këtij definicioni Bloomfield kërkon folësin e përkryer të të dy gjuhëve.

Ngjashëm me Bloomfield edhe Brown kërkon një zotërim të plotë të dy gjuhëve *“active, completely equal mastery of two or more languages”*.⁴ Këto përkufizime maksimaliste mund të bëjnë të qartë se këtu bëhet fjalë për dygjuhësinë e përsosur dhe këtu lind pyetja, atëherë, kur mund të quhet një person bilingual apo kurrë askush nuk mund të jetë folësi perfekt i dy gjuhëve?

Në kundërshtim me këtë pozicionin maksimal të Bloomfield-it dhe Brown-it, janë përkufizimet që kanë pozicion të kundërt dhe flasin për një aftësi minimale gjuhësore që mund të ketë një individ dhe të përcaktojë një individ si dygjuhësh. Këto pikëpamje minimale ndër të tjera përfaqësohen nga Haugen (1953) dhe MacNamara (1969).

Sipas Haugen *“Die Zweisprachigkeit beginnt dort, wo der Sprecher einer Sprache komplette, inhaltstragende Äußerungen in der anderen Sprache erzeugen kann. Dygjuhësia fillon aty kur një folës mund të prodhojë deklaratat komplete dhe përmbajtësore në gjuhën tjetër”*⁵.

MacNamara (1969) shkon edhe më tej me qëndrimin e tij minimal dhe jep përkufizimin, se, një individ mund të jetë bilingual, nëse është në gjendje të flas një gjuhë të dytë në një masë minimale në të gjitha

³ Bloomfield 1933, f. 56.

⁴ Braun 1937, f. 115.

⁵ Haugen 1953, f. 7.

shkathtësitë siç janë: leximi, dëgjimi, shkrimi dhe të folurit me gojë⁶. Edhe më tej shkon përkufizimi i Diebold-it (1964) për definicionin e dygjuhësisë, ku ai i redukon aftësitë e gjuhës në një kuptim më pasiv dhe sjell termin “*incipient bilingualism*”⁷ duke u mbështetur tek folësit të cilët fillojnë ta kuptojnë gjuhën e dytë apo të huaj edhe pa qenë përdorues aktiv të gjuhës së huaj. Sipas definicionit të Diebold-it çdo folës mund të përshkruhet si dygjuhësh, sepse pothuajse çdo njeri i di disa fjalë në një gjuhë tjetër dhe kjo pastaj u cilësua nga linguistët si bilingual “*receptive*” apo “*passive*”. Në bazë të përkufizimeve ekstreme maksimale dhe minimale të elaboruara deri tani mund të konstatojmë se vështir mund të arrijmë në një përkufizim të përgjithshme të kësaj problematike. Por duke marrë për bazë qëndrimin maksimal lidhur me përkufizimin e folësit të përsosur dygjuhësh dhe qëndrimin minimal të folësit me përdorim minimal të gjuhës së huaj, studiuesit si Mackey (1968), Hardin/Riley (1987) sjellin një perspektiv tjetër lidhur me kompetencën gjuhësore bilinguale. Ata thonë, se do të kishte më shumë kuptim të përcaktohej shkalla e aftësive dygjuhëshe, në vend që të zgjedhin një vijë radikale, me kufij të përcaktuar në mënyrë rigorozë, nëse një folës është dygjuhësh apo jo dhe sipas mendimit të Romain (1985) dhe Myers-Scotton (2006)⁸ dygjuhësia apo shumëgjuhësia nuk është gjendje e jashtëzakonshme kogniktive apo shoqërore.

Sipas Rosemarie Tracy⁹ pyetja duhet të parashtrohet më shume në atë se, çfarë mund të ofroj shkenca e gjuhës, për të adresuar keqkuptimet më të zakonshme dhe të punojë në krahasimin e hulumtimeve aktuale që kanë të bëjnë me potencialin shumëgjuhësh të trurit të njeriut?

Format dhe pasojat e dygjuhësisë

Pas kësaj pasqyre të shkurtër që është dhënë në lidhje me klasifikimet e mundshme të folësve dygjuhësh, por që këto nuk janë të gjitha llojet, në këtë pjesë do mundohem të japë pasqyrime mbi format dhe pasojat e dygjuhësisë, ku mund të shohim më tej se edhe këtu kemi kryqëzime rreth teorisë së përvetësimit të gjuhës së dytë. Por për shkak

⁶ MacNamara 1969, f. 82.

⁷ Diebold 1964, f. 469.

⁸ Tanja Anstatt 2001, (Hrsg.), “*Mehrsprachigkeit bei Kindern und Erwachsenen*”, f. 86.

⁹ Po aty. f. 86.

të volumit të gjerë të kësaj problematik, në këtë pjesë të punimit nuk do të shkojë në shpjegim të detajuar të përvetësimit e gjuhës së dytë, por do të shpjegojë rëndësinë e moshës në mësimin e një gjuhë tjetër si dhe kompetencën komunikuese gjuhësore.

Sipas mendimit të Meisel dhe Dimroth (2001)¹⁰ faktori i parë dhe shumë i rëndësishëm është mosha e individit në të cilën fillon kontakti me gjuhën e dytë. Kjo moshë është e ndarë në tre grupe.

Në grupin e parë hyjnë fëmijët të cilët para se t'i mbushin 3 vjet vijnë në kontakt me gjuhën e dytë dhe kanë një input të rregullt në të dy gjuhët. Këtu bëhet fjalë për mësimin e dy gjuhëve në të njëjtën kohë¹¹.

Në grupin e dytë janë fëmijët që pasi t'i mbushin tre vjet vijnë në kontakt me gjuhën e dytë, e cila më pas përcaktohet si mësim fëmijëror i gjuhës së dytë.

Dhe grupi i tretë, i ashtuquajtur *erwachsene Zweitspracherwerb*¹², mësimi i gjuhës së dytë në moshën më të rritur, gjegjësisht në moshën 10 vjeçare.

Siç e përshekruam më sipër, mosha e individit për mësimin e gjuhës së huaj luan një rol të rëndësishëm në neuropsikologjinë, kongnitivitetin dhe zhvillimi socio-kulturor të një personi dygjuhësh dhe në këtë mënyrë fëmijët mund të mësojnë një gjuhë të dytë më lehtë dhe më mirë se sa të rriturit, sepse qasja e tyre është më e natyrshme, e cila mbështetet nga zhvillimi i gjuhës. Nëse fëmijët deri sa të hyjnë në adoleshencë nuk e mësojnë një gjuhë të dytë, ata më vonë kurrë nuk do të jenë në gjendje të mësojnë gjuhën e huaj ashtu siç duhet. Këtë qëndrim e arsyeton Romain (1989) me hipotezën e periudhës kritike/*critical period hypothesis*:

“This critical period supposedly lasts until the age of puberty, after time language acquisition becomes more difficult due to a loss of plasticity in the brain and the specialization of the left hemisphere for language functions / Kjo periudhë kritike zgjatë deri në pubertet, pasi që, pas kësaj kohe hemisfera e majtë e trurit e humb plasticitetin dhe i vështirëson funksionet gjuhësore”.

Duke marrë parasysh këtë hipotezë atëherë mund të konstatojmë se ekziston një lidhshmëri biologjike në mes të moshës dhe aftësisë për

¹⁰ Christine Dimroth und Jürgen Meisel, in Tanja Anstatt Hrsg. Mehrsprachigkeit bei Kindern und Erwachsenen, 2001, f. 140.

¹¹ Tanja Anstatt und Elena Dieser, 2001, f. 140.

¹² Po aty, f. 141.

të mësuar një gjuhë tjetër, kështu që fëmijët mund t'i quajmë folës të vërtetë dygjuhësh.

Kjo teori u kundërshtua pastaj më vonë nga gjuhëtarë të kohës së re, si Neufeld (1979) dhe Klein (1972), të cilat janë të mendimit që të rriturit mund të kenë një shkallë të lartë të aftësive dygjuhësore. Epërsia e të mësuarit të një gjuhe të huaj në moshën e rritur, është se i rrituri pasi veçmë ka mbyllur ose ka përfunduar procesin për mësimin e gjuhës së pare, tani ka në dispozicion aftësitë analitike dhe konceptuale që të mësoj gjuhën e dytë apo të tretë. Por për përkufizimin e çështjes së moshës së fëmijëve apo të rriturit për mësimin e gjuhës ende ka rezerva dhe ka të bëj shumë më tepër me fëmijët apo të rriturit e migruar, ku ekziston frika se ata mund pjesërisht ose tërësisht ta harrojnë gjuhën e parë.

Besohet se ndarja strikte e dy gjuhëve në input mund të rezultojë me një vonesë për përvetësimin e gjuhës, ose edhe një përvetësim të papërsosur të dy gjuhëve. Kështu dhe Blocher përshkruan rreziqet dhe pretendon se *“daß Zweisprachigkeit einen großen Aufwand an Zeit und Kraft koste, das Sprachgefühl abstumpfe, sie zu Sprachmischung führe und ‚sitliche Gefahren‘ mit sich bringe. Hierunter versteht er bspw., eine Schwächung des Heimatgefühls, der Vaterlandsliebe und der Freude am angestammten Volkstum / se dygjuhësia shpenzon një pjesë të madhe të kohës dhe të energjis dhe se humbet ndjenja e gjuhës dhe çon në përzjerjen e gjuhës për të sjellë pastaj me vete rreziqe morale. Kjo nënkupton, për shembull, zbehjen e ndjenjës për vendlindjen, atdhedashurinë dhe harmoninë e prejardhjes kombëtare”*¹³.

Opinionet e lartpërmendura nga Ingrid Gogolin dhe Hans-Joachim Roth të cilët kanë për temë dygjuhësinë në kontekstin e migrimit, kanë hasur në vëmendjen ciklike të publikut¹⁴.

Dygjuhësia në Gjermani dhe histori e shkurtër e punëtorëve mysafirë “Gastarbeiter” në Gjermani

Deri në vitin 1955, kur Gjermania kishte nënshkruar marrëveshjet për rekrutimin e punëtorëve në vendet jugore si Italia, Spanja, Greqia, ish-Jugosllavia dhe Turqia dhe ndodhi mrekullia ekonomike, Gjermania ka qenë një shtet njëgjuhësh. Një rishikim i shkurtër i historisë së

¹³ Blocher 1982, in Kupfer/Schreiner 1994, f. 51

¹⁴ Ingrid Gogolin / Hans-Joachim Roth, in Tanja Anstatt (Hrsg.), Mehrsprachigkeit bei Kindern und Erhasenen 2001, f. 32

migrimit në Gjermani e bëhen të qartë ndryshimin në favor të dygjuhësisë. Në këtë periudhë ishin punëtorët e parë të ftuar të ashtuquajturit “Gastarbeiter”¹⁵ nga vendet e lartpërmendura që udhëtojnë për në Gjermani dhe ishte supozuar se koha e qëndrimit të tyre do të jetë e kufizuar në vendin pritës dhe nuk ishte parë e nevojës për një integrim shoqëror dhe gjuhësor të këtyre punëtorëve. Por ndodhi e kundërta, pasi qëllimi për kthimin e punëtorëve të huaj në vendet e tyre nuk mund të realizohej. Njëra nga shumë arsyet ishte se punëtorët e huaj i sollën familjet e tyre në Gjermani. Kështu Republika Federale e Gjermanisë pas një periudhe të gjatë siç ishte me një shoqëri monolingual u shndërrua në një shoqëri shumëgjuhëshe në të cilën bën pjesë edhe gjenerata e tretë e fëmijëve të punëtorëve të huaj.

Gjenerata e dytë dhe e tretë e fëmijëve të punëtorëve të huaj në Gjermani

Përderisa gjenerata e parë d.m.th punëtorët e huaj në Gjermani luftonin me vështirësi të tjera të tilla si mungesa e aftësive gjuhësore në gjermanisht, malli për vendlindje e tjera, gjenerata e dytë e fëmijëve të punëtorëve të huaj paraqitet në medime si, të pezulluar, të pashansë dhe të nënshkruar.

Gunilla Fincke ka shqyrtuar këtë pyetje në librin e saj “Abgehängt, chancenlos, unwillig?: Eine empirische Reorientierung von Integrationstheorien zu MigratInnen der zweiten Generation in Deutschland”¹⁶. Duke iu referuar publikimit të rezultateve të studimit PISA (*Programm for international Student Assessment*)¹⁷ përfaqësohet teza se bëhet fjalë për rënien e gjeneratës së dytë d.m.th. supozohet se gjenerata e dytë e fëmijëve të punëtorëve me prapavijë migrimi kanë shanse të dobëta arsimimi dhe status kritik në shtet, se sa gjenerata e parë. Megjithatë, më vonë, Fincke (2009) në punën dhe kërkimin shkencor të saj merr pozitë të kundërt me atë se si paraqitet gjenerata e dytë në medime. Ajo e argumenton tezën se brezi i dytë i emigrantëve në Gjermani në aspektin socio-ekonomike dhe kulturore ka shumëllojshmëri të gjerë të pozicionimit në shoqëri dhe është burim i pasura në pozicionin e përgjithshëm sesa gjenerata e parë.

¹⁵ Termi “Gastarbeiter” që në perkthim d.m.th “punëtorë mysafirë” u përdor për herë të parë për punëtorët e huaj të rekrutuar në vitin 1960 në Gjermani.

¹⁶ Gunilla Fincke, 2009, f. 11.

¹⁷ Po aty, f. 11.

Në të vërtetë, sipas Ott, në diskutimin e shkaqeve të arritjeve më të ulëta arsimore të fëmijëve dhe të rinjve të huaj shpesh nuk bëhet diferencim i mjaftueshëm. Problemet gjuhësore janë sjell në lidhshmëri me përkatësin gjuhësore apo etnike dhe shihen si një rezultat i drejtpërdrejtë i edukimit shumëgjuhësh ose ato janë sjellë në lidhshmëri me statusin ligjor dhe social të pakicave gjuhësore dhe etnike, dhe është parë si rezultat i lidhjeve të veçanta midis shumicës dhe pakicës. Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se gjenerata e dytë gjendet midis dy poleve, në mes të gjuhës dhe kulturës se origjinës dhe gjuhës dhe kulturës së vendit pritës.

Ndryshe nga gjenerata e dytë, e cila është e vendosur në mes të dy botëve, gjenerata e tretë ndihet gjithnjë e më shumë e integruar në gjuhën dhe kulturën gjermane, për vetë faktin sepse gjuha amtare flitet vetëm brenda familjes dhe farefisnisë. Brezi i tretë ka të bëj shumë me atë që është, do të thotë me termin e “identitetit”, identitetin gjuhësor, kulturor dhe identitetin e vetvetes. Në shumë studime në lidhje me brezin e dytë dhe të tretë flitet për pasigurinë dhe përkatësin e identitetit dhe lidhshmëria në mes të gjuhës dhe identitetit është duke u marrë si pikënisje e kësaj problematike.

Problematikën për teorinë e identitetit e përfaqësojnë Mead (1973), Goffman (1980) dhe Krappman (1988)¹⁸, me ç’rast nuk do të hymë në sqarimin e çdo funksion veç e veç dhe si rezultat i faktorëve të lartpërmendur gjeneratat e ardhshme do të kenë vështirësi për tu integruar në shoqërinë e shumicës. Prandaj, ajo duhet të jetë një temë tjetër e hulumtimeve të ardhshme shkencore të integritit të njerëzve me prejardhje emigrante.

Conclusion

This study presents the concern which is primarily linked to different aspects of bilingualism and multilingualism, where as a phenomenon is bilingualism, maintaining the mother language of the second and third generation of foreign workers, as well as people with immigrant background in Germany. According to research done in the aforementioned science fields, it is clearly visible that people who gather in different places in the world, in this case the foreign workers

¹⁸ <http://www.linse.uni-due.de/lins> (10.03.2017)

who went to Germany in the 1960s and 70s, face considerable challenges even later on, namely third generation children now face language and cultural identity problems.

In conclusion, we can suggest that science in the future do more research on ways and methods using which, third and future generations won't have to suffer or lose the language and culture, but to conserve them and simultaneously integrate in the society of the majority.

Literatura

Anstatt, T. (2007): Mehrsprachigkeit bei Kindern und Erwachsenen. Erwerb – Formen – Förderung. Tübingen: Attempo.

Beatens-Beardsmore, H. (1982): Bilingualism: Basic Principles. Clevedon, Avon, England: Multilingual Matters.

Blocher, E. (1909): Zweisprachigkeit. Vorteile und Nachteile. Langensalza.

Bloomfield, K. (1993): Language. New Yourk: Holt.

Diebold, A. R. (1964): Incipient bilingualism. In: Hymes, D. Et. Al. Language in Clture and Society. New Yourk: Harper und Row.

Finke, G. (2009): Abgehängt, chancenlos, unwillig?: Eine empirische Reorientierung von Integrationstheorien zu MigrantInnen der zweiten Generation in Deutschland. VS Verlag für Sozialwissenschaften.

Haugen, E. (1953): The Norwegian Language in America. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.

Kupfer / Schreiner, C. (1994): Sprachdidaktik und Sprachentwicklung im Rahmen interkulturelle Erziehung. Das Nürnbergermodell. Weinheim.

Siebert-Ott, G. (2001): Frühe Mehrsprachigkeit. Probleme des Grammatikerwerbs in multilingualen und multikulturellen Kontexten. Tübingen: Max Niemeyer Verlag.

Burime interneti <http://www.linse.uni-due.de/lins> (04.03.2017)